




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Ucp. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot Prot No	01-2576/12
Data Datum Date	25-07-2012
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **25.06.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4792/11, për z. *Vesimir Saviç* – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4792/11, për Zyrtarin e lartë, z. *Vesimir Saviç* – Deputet në Kuvendin e Kosovës është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), sipas të cilit është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në ndërrmarjen private, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të konfliktit të interesit konsiderohet papajtushmëri funksionesh, prandaj, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, z. *Vesimir Saviç*, është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit, dhe në bisedë me zyrtarët e Agjencisë është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas këtij takimi, zyrtari i lartë, z. Saviç, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellur dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, me informacionet mbi biznesin N.T.SH.“Bezi 2”, në të cilat shihet se ky zyrtar i lartë ka heq dorë nga çdo funksion në këtë ndërmarrje private. Dokumenti ka numër protokoli DPK/DPKI 03-1397/2012.

Kështu, me këto informacione zyrtare , kemi konstatuar se është shmangur situata e mundshme e konfliktit të interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

